



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E SHENDETESISE**  
**QENDRA KOMBETARE E EDUKIMIT NE VAZHDIM**

---

**Disa ndryshime ne ‘Dokumentin rregullator për AKREDITIMIN e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë’**

1. Në kapitullin III, pika A, mbas paragrafit të parë të shtohet paragrafi, si vijon:  
“Për përsëritjen e aktiviteteve që janë akredituar më parë nga QKEV-ja, çdo organizues ka detyrimin të dërgojë në QKEV një njoftim me shkrim, të shoqëruar me programin e aktivitetit, të paktën 7 ditë kalendarike përpara zhvillimit të tij.”
  
2. Në kapitullin III, pika C, në vijim të pikës 1 paragrafit të parë të shtohet si vijon:  
‘Në rast të plotësimit të pjesshëm nga ofruesit të dokumentacionit të kërkuar, QKEV ruan të drejtën e mosvlerësimit me kredite për ato tema të programit që kanë mangësi në dokumentacion.’
  
3. Në kapitullin III, pika C.2, fjalia : ‘QKEV-ja ngarkon një ekspert të pavarur...’ shtohet si vijon: “QKEV-ja ngarkon një *ose me shumë ekspertë të pavarur...*”
  
4. Në kapitullin III, pas pikës C.3 të vijohet me :  
‘Në varësi të këtij vlerësimi, eksperti mund të sugjerojë se cilat tema duhen konsideruar ose jo në llogaritjen e krediteve.’
  
5. Në kapitullin III, pika E, pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi i mëposhtëm:

‘Për aktivitete të edukimit në vazhdim që nuk kalojnë në procedurën e vlerësimit të organizimit të aktivitetit nga vete ofruesit e tyre, QKEV-ja, ka të drejtë të realizojë vlerësimin e organizimit të këtij aktivitetit.’

6. Në kapitullin III, pika E, në paragrafin e 3, fjalia “QKEV-ja mund të anulojë akreditimin e ofruar...” vijon si më poshtë:  
“QKEV-ja mund të anulojë akreditimin e ofruar, apo të rishikojë numrin e krediteve,.....”

7. Në kapitullin III, pika E, pas paragrafit të dytë, të shtohet paragrafi si vijon :

- Vlerësimi negativ i shumicës së pjesemarrësve për
  - a) organizimin e aktivitetit,
  - b) përmbajtjen e temave të vecanta, apo
  - c) nivelin pedagogjik të paraqitjes së këtyre temave.

8. Në kapitullin VII, pika B, tek Roli i Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, nën-pika 3, fjalia ‘.....1) hartimit.....’ të shtohet si më poshtë :  
“hartimit dhe garantimit të zbatimit”.....

9. Në Aneksin 1 “Tarifat për Akreditimin e Aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim nga QKEV, pas paragrafit të fundit të shtohet paragrafi si vijon:

\* Përjashtohen nga tarifat për akreditimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim të gjitha institucionet shëndetësore publike, të cilat organizojnë aktivitete të edukimit në vazhdim vetëm për profesionistët e organizatës së tyre.